

Emri i Lëndës : Parimet e menaxhimit							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
IMC 203	B	Vjeshtë	3.00	0.00	0.00	3.00	5.00
Lektori		Elda Dollija, PhD					
Asistenti		Norga Sulo, MSc					
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Lënda Menaxhim ka si qëllim kryesor të pajisë studentët me njohuritë bazë më bashkëkohore në fushën e menaxhimit të organizatave (publike, private dhe jofitimprurëse). Programi i modulit është konceptuar si një tërësi njohurish themelore, të cilat do të thellohen më tej nga studentët në vitet e mëvonshme, në fushat e tjera. Duke u bazuar në këtë mënyrë konceptuale programi përfshin njohuri të domosdoshme mbi konceptin e menaxhimit dhe rolin e tij në biznese, paraqitjen e sfondit historik të zhvillimit të shkencës menaxheriale, shqyrtimin e raportit menaxher- organizatë, identifikimin dhe sqarimin e funksioneve bazë menaxheriale: planifikimin, organizimin, ushëheqjen dhe kontrollin.					
Objektivat		• T'i pajisë studentët me njohuritë bazë mbi rolet dhe funksionet e një menaxheri në organizatat e biznesit. • Të analizojë në mënyrë të detajuar mjedisin në të cilin operojnë organizatat me qëllim që vendimet menaxheriale të jenë me një nivel të lartë efektiviteti menaxherial. • Të orientojë studentët që të përdorin në mënyrë racionale teknikat ndihmëse në funksion të përmirësimit të cilësisë së menaxhimit. • Të aftësojë studentët që njohuritë e fituara gjatë këtij kursi t'i përdorë në funksion të formimit të tij dhe njëkohësisht të orientohet me sukses në praktikatat e biznesit.					
Konceptet Kryesore		Menaxhim, mjedis, planifikim, prognozim, organizim, strukturë, marrëdhënie, autoritet, delegim, centralizim, decentralizim, departamentizim, udhëheqje, stile, motivim, burime njerëzore, kontroll, operacione.					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Menaxheret dhe Menaxhimi Në këtë temë, studentët do të njihen me këto çështje: kush janë menaxherët dhe ku punojnë ato? Cfarë është menaxhimi? Përse të studiojmë menaxhim? Cilat janë 4 funksionet e menaxhimit, rolet e menaxherit dhe aftësitë menaxheriale? Faktorët që po ridimensionojnë menaxhimin. (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 24-47)						
2	Zhvillimi historik i shkencës së menaxhimit Në këtë temë, studentët do të njihen me këto çështje: Lindja e shkollave të menaxhimit, Shkollat klasike, Shkolla e sjelljes, Shkolla sasiore, Teoritë moderne të menaxhimit, Perspektiva të reja të menaxhimit. (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 49-56)						
3	Çfarë është Kultura Organizative? Në këtë temë, studentët do të njihen me këto çështje: çfarë është ambienti i jashtëm dhe përse është i rëndësishëm ai? Çfarë roli luajnë të dhënat demografike? Si ndikon kultura organizative në punën e menaxherëve dhe punonjësve? (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 56-80)						
4	Procesi i vendimmarrjes Në këtë kapitull studentët do të njihen me temat e mëposhtme: Përcaktimi i procesit të vendimmarrjes. Shpjegoni tre qasjet e vendimmarrjes. Përcaktoni kushtet në të cilat menaxherët marrin vendime (siguria, rreziku dhe pasiguria). Si i marrin vendimet grupet. Problemet bashkëkohore me të cilat përballen menaxherët gjatë marrjes së vendimeve sot. (Robins, Coulter & DeCenzo f. 110-141)						
5	Metodat sasiore të vendimmarrjes Në këtë kapitull studentët do të njihen me këto tema: Matrica e rezultateve (metoda maksimale, maksimumi, minimaks), Pema e vendimeve, Analiza e pikës kritike, Analiza e raporteve, Programimi linear. (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 141-151)						

6	Bazat e planifikimit Në këtë kapitull, studentët do të njihen me temat e mëposhtme: Çfarë është Planifikimi dhe pse menaxherët duhet të planifikojnë? Pse menaxherët duhet të dinë për menaxhimin strategjik? Pse menaxherët vendosin qëllime dhe plane? Llojet e qëllimeve dhe planeve. Me çfarë çështjesh bashkëkohore përballen menaxherët sot se sa planifikimi (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 152-182)
7	Përsëritje
8	provimi gjysem final
9	Struktura organizative Në këtë kapitull, studentët do të njihen me temat e mëposhtme: Cilat janë gjashtë elementet kryesore në struktura organizative (Specializimi, Departamentizimi, Autoriteti, Përgjegjësia, Kontrolli, Centralizimi, Decentralizimi, Formalizimi). Cilat variabla të rastësishëm ndikojnë në zgjedhjen strukturore? Strukturat e ndryshme organizative. Sfidat e strukturave organizative. (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 182-218)
10	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore Në këtë kapitull, studentët do të njihen me temat e mëposhtme: Çfarë është procesi i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe çfarë ndikon në të? Pse menaxherët identifikojnë dhe përzgjedhin punonjësit kompetent? Si u sigurohen punonjësve aftësitë dhe njohuritë e nevojshme? (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 218-254)
11	Menaxhimi i ndryshimit dhe inovacionit Në këtë kapitull, studentët do të njihen me temat e mëposhtme: Çfarë është ndryshimi dhe si merren me të menaxherët? Si e menaxhojnë menaxherët rezistencën ndaj ndryshimit? Çfarë reagimesh kanë punonjësit ndaj ndryshimit organizativ? Si mund të inkurajojnë menaxherët ndryshimet organizative? (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 258-286)
12	Bazat e sjelljes individuale. Në këtë kapitull, studentët do të njihen me temat e mëposhtme: Cilat janë fokusi dhe qëllimet e Sjelljes organizative? Çfarë roli luajnë qëndrimet në performancën e punës? Çfarë duhet të dinë menaxherët për personalitetin? Çfarë është perceptimi dhe çfarë ndikon në të? (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 286-320)
13	Motivimi dhe shpërblimi i punonjësve Në këtë kapitull, studentët do të njihen me temat e mëposhtme: Çfarë është motivimi? Katër teoritë e hershme të motivimit: Teoria e Hierarkisë së Nevojave të Maslow, Teoria X dhe Y e McGregroy, Teoria e Dy Faktorëve të Herzberg, Teoria e Tre Nevojave të McClellands. Si e shpjegojnë teoritë bashkëkohore motivimin? Me cilat çështje aktuale të motivimit përballen menaxherët sot? (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 350-382)
14	Teorite e liderit Menaxherët kundrejt liderave, teorite e liderit, studimet ohio state, modeli Fiedler Lideri situacional, lideri karizmatik, lideri vizionar, lideri transaksional, lideri transformues, Lideri autokratik. (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 382-413)
15	Bazat e kontrollit. Në këtë kapitull, studentët do të njihen me temat e mëposhtme: Çfarë është kontrolli dhe pse është i rëndësishëm? Çfarë ndodh kur menaxherët kontrollojnë? Çfarë duhet të kontrollojnë menaxherët? (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 442-472)
16	Provimi final
Parakushtet	
Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
• Bazat e menaxhimit, përkthim i AADF, autoret: Stephen P Robbins, Mary Coulter & David De Cenzo, botimi 11-te	
Referenca të tjera	
• Manaxhimi, Shyqyri Llaci, Tirane, 2017	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të jenë të aftë të evidentojnë rëndësinë e menaxhimit të organizatave të biznesit dhe jo vetëm
2	Studentët do të pajisen me njohuri për rolin e menaxherit në organizatë
3	Studentët do të realizojnë analiza kritike të problemeve dhe sfidave bashkëkohore menaxheriale
4	Studentët do të evidentojnë funksionet kryesore menaxheriale si planifikimi, organizimi, udhëheqja dhe kontrolli
5	Studentët do të përmirësojnë aftësitë e prezantimit të punëve individuale dhe në grup

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme		Sasia	Përqindja
Gjysmë finale		1	40
Kuize		0	0
Projekte		1	10
Projekte semestrale		0	0
Punë laborator		0	0
Pjesëmarrja në mësim		1	10
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			60
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			40
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	1	10	10
Gjysmë finale	1	12	12
Provimi final	1	13	13
Të tjera	0	9	0
Ngarkesa totale e orëve			125
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.00
ECTS			5.00